



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME

Numri i lëndës: 2019:210363
Datë: 29.01.2025
Numri i dokumentit: 06775167

Rev.nr.582/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Rrustem Thaqi, kryetar i kolegjit, Zenel Leku dhe Milena Gjeriq, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike - kontestimore të paditëses: V. P. nga P., të cilën e përfaqëson Fatbardh Makolli, avokat në P., sipas autorizimit, kundër të paditurës: Byroja Kosovare e Sigurimeve (BKS), me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson përfaqësuesja e autorizuar D. S., sipas autorizimit, për kompensim të dëmit material dhe jomaterial, duke vendosur lidhur me revizionin e paditëses të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.9487/2021, të datës 23.04.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 23.01.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET i pabazuar revizioni i paditëses: V. P. nga P., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.9487/2021, të datës 23.04.2024.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm C.nr.483/16, të datës 15.06.2021, është vendosur: I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditëses V. P. nga P., detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimeve, me seli në Prishtinë, që paditëses në emër të kompensimit të dëmit, për aksidentin e datës 15.08.2012, nga baza e auto përgjegjësisë, për 50% të përgjegjësisë, t'ia paguaj shumat e specifikuar si më poshtë: Dëmi jo material - kompensim, në emër të dhimbjeve të përjetuara fizike, shumën prej 1,400 €, kompensim, në emër të frikës së përjetuar, shumën prej 1,150 €, kompensim, në emër të shëmtimit trupor, shumën prej 375 €, kompensim, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 3,040 €. Dëmi material - kompensim, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, shumën prej 175 €, kompensim, në emër të ushqimit të përforcuar, shumën prej 175 €, kompensimi, në emër të shpenzimeve të mjekimit, shumë prej 19 €. II. Detyrohet e

paditura që paditëses, shumat e gjuara si në pikën I, të dispozitivit të këtij aktgjykimi në emër të dëmit jomaterial, t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 15.06.2021 (data e marrjes së aktgjykimit), ndërsa shumat e gjuara në emër të dëmit material t'ia paguaj me kamatë ligjore prej 8% në vit, nga data 08.03.2016 (data e paraqitjes së padisë në gjykatë), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,033 €, e të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbartimit me detyrim. III. Refuzohet pjesa e kërkesëpadisë së paditëses dhe atë në emër të kompensimit për dhimbjet e përjetuara fizike, në shumë prej 6,600 €, në emër të kompensimit për frikën e përjetuar, në shumë prej 6,350 €, në emër të shëmtimit trupor, në shumë prej 4,625 €, në emër të zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, në shumë prej 16,960 €, në emër të kompensimit për ndihmë dhe kujdes të huaj, në shumë prej 1,825 €, në emër të ushqimit të përforcuar, në shumë prej 1,325 €, në emër të rehabilitimit fizioterapeutik dhe klimatik, në shumë prej 1,000 €, në emër të shpenzimeve të mjekimit, në shumë prej 1,981 € dhe në emër të shpenzimeve të procedurës, në shumën prej 985.85 €, si e pa bazuar.

Gjykata e Apelit të Kosovës, duke vendosur sipas ankesës të paditëses, me aktgjykimin Ac.nr.9487/2021, të datës 23.04.2024, ka vendosur: I. Refuzohet e pabazuar ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses V.P. nga P., ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.483/16 i datës 15.06.2021, në pikën I, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë, që ka të bëjë me dëmin material dhe atë, në emër të ndihmës dhe kujdesit të huaj, ushqimit të përforcuar, shpenzimeve të mjekimit dhe në pikën II, të dispozitivit, në pjesën që ka të bëjë për kamatën, vërtetohet. II. Pranohet pjesërisht ankesa e përfaqësuesit të autorizuar të paditëses V. P., nga P., Ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.483/16 i datës 15.06.2021, në pikën I, të dispozitivit, në pjesën e kërkesëpadisë, për kompensimin e dëmit jomaterial dhe atë: për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor dhe gjykohet si në vijim: Detyrohet e paditura Byroja Kosovare e Sigurimit (BKS), me seli në Prishtinë, rruga "Lidhja e Pejës" pa nr., që paditëses V. P., nga P., në emër të kompensimit të dëmit jomaterial, të pësuar në aksidentin e komunikacionit rrugor të datës 15.08.2015, për 50% të përgjegjësisë, ti paguaj shumat dhe atë: për dhimbjet fizike ti paguaj, shumën prej 2,000 €, për frikën e përjetuar, shumën prej 1,500 €, për zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shumën prej 3,500 € dhe për shëmtimin trupor, shumën prej 500 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesëpadisë për dhimbjet fizike, frikën e përjetuar, zvogëlimin e aktivitetit të përgjithshëm jetësor dhe shëmtimin trupor, përtej shumave të gjuar, refuzohet si e pabazuar. III. Mbetet i pashqyrtuar dispozitivi i aktgjykimit të atakuar në pikën II, në pjesën shpenzimeve të procedurës.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë, paditësja përmes të autorizuarit të saj, në afatin ligjor ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës të pranoj revizionin, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë ta ndryshoj dhe ta aprovojë në tërësi kërkesëpadinë e paditëses, në lartësi të shumave të propozuara sikurse në plotësimin e revizionit të datës 16.10.2024.

E paditura nuk ka paraqitur përgjigje në revizionin e të autorizuarit të paditëses.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditëses është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja, më datë 08.03.2016, në gjykatën e shkallës së parë, ka paraqitur padi kundër të paditurës, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses, në emër të kompensimit të dëmit material dhe jomaterial t'ia paguajë shumën e kërkuar më saktësisht si në parashtresën për precizmin e padisë të datës 26.03.2021.

Gjykata e shkallës së parë, duke vendosur sipas padisë së paditëses, kundër të paditurës, pas vlerësimit dhe administrimit të provave, pas mbajtjes së seancës për shqyrtim kryesor ka nxjerr aktgjykimin C.nr.483/16, të datës 15.06.2021, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht kërkesëpadinë e paditëses, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë, ndër të tjera ka theksuar se duke vepruar sipas padisë së paditësit, në procedurën e provave ka administruar këto prova: Raportin policor të aksidentit nr. ..., të datës 15.08.2012, Skicën e vendit të ngjarjes, Fletëlëshimin e lëshuar nga QKUK-ja, nr. ..., të datës 14.08.2012, Raportin nga QKUK-ja, të datës 06.11.2012, Raporti nga Konsulta, të datës 24.09.2012, Raportin nga Konsulta nr. ..., të datës 23.04.2013, dy Udhëzime për Konsultim, Raportin nga Konsulta të datës 29.04.2013, Raportin nga Konsulta të datës 01.11.2012, Raportin nga Konsulta të datës 02.11.2012, Raportin nga Konsulta nr. ..., të datës 27.09.2012, Raportin nga QKUK-ja, nr. ..., të datës 14.08.2012, Raportin nga Konsulta nr. ..., të datës 28.05.2013, Raportin nga Konsulta nr. ..., të datës 24.07.2014, Raportin nga Konsulta nr. ..., të datës 01.11.2012, Raportin nga Konsulta nr. ..., të datës 29.04.2013, Raportin nga Konsulta nr. ..., të datës 23.04.2013, ... Dëftesa, ... Foto të paditëses, ekspertizën mjekësore të datës 16.02.2021, dhe ekspertizën e komunikacionit të datës 05.03.2021.

Ka shtuar se sipas raportit të policisë, aksidenti ka ndodhur më datë 15.08.2012, në ora 18:00, në P., tek "K.P.", në të cilin e dëmtuara ka qenë në cilësinë e këmbësore dhe si pasojë e të cilit ka pësuar lëndime të rënda trupore. Ndërsa, sipas ekspertizës së ekspertit të komunikacionit deri tek shkaktimi i aksidentit ka ardhur me lëshime nga ngasësi i automjetit A, i siguruar tek e paditura, i cili nuk e kishte vigjilencën e duhur gjatë lëvizjes në rrugë ku gjenden edhe këmbësoret dhe lëshimet e këmbësores B, tani paditëses, e cila ka vepruar me pakujdesi gjatë kalimit të rrugës në magjistrale, e cila kishte filluar të kaloj 25m, rrugën tërthorazi, dhe që si rrjedhojë që të dy pjesëmarrësit A dhe B, i kanë dhënë kontribut të barabartë aksidentit.

Sipas gjykatës së shkallës së parë, kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse ishte baza juridike dhe lartësia e kërkesëpadisë së paditëses.

Për të vërtetuar bazën juridike të kërkesëpadisë, gjykata në cilësinë e provës materiale ka nxjerr ekspertizën e komunikacionit, të punuar nga eksperti S. B., të datës 05.03.2021, mbi bazën e të cilës, ka vërtetuar se të dy pjesëmarrësit e involvuar në aksidentin e komunikacionit, i kanë dhënë kontribut të barabartë shkaktimit të aksidentit. Gjykata, ekspertizën e komunikacionit e ka vlerësuar si profesionale dhe të argumentuar mirë dhe të njëjtë e ka pranuar në tërësi si të besueshme, andaj, ka vlerësuar se në rastin konkret të dy pjesëmarrësit kanë përgjegjësi të ndarë

në shkaktimin e aksidenti, ashtu që përgjegjësia e tyre sipas kontributit, ndahet në përgjegjësi solidare 50 % për të paditurën dhe 50 % për paditësen.

Sa i përket bazës juridike të kërkesëpadisë, përkatësisht përgjegjesisë së të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar paditëses si pasojë e aksidentit të komunikacionit, gjykata ka konstatuar se e njëjta ka mbështetje në dispozitat nga neni 136, 137 dhe 140 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD). Ndërsa, sa i përket përgjegjesisë së ndarë gjykata ka aplikuar dispozitat e nenit 176 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve (LMD).

Ka theksuar se sa i përket lartësisë së kërkesëpadisë e njëjta është vërtetuar nëpërmes ekspertizës nga lëmia e ortopedisë dhe psikiatrisë, të punuar me shkrim më datë 16.02.2021, të dhënë nga Dr. M. H., ortoped-traumatolog dhe Dr. V. S., psikiatër, të cilët kanë dhënë mendimin profesional, me ç'rast janë deklaruar për natyrën, shkallën dhe pasojat e lëndimeve që ka pësuar paditësja si pasojë e aksidentit.

Në bazë të ekspertizave mjekësore të ortopedisë dhe psikiatrisë dhe pas ekzaminimeve përkatëse, gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar se paditësja ka pësuar lëndime të rënda trupore si pasojë e aksidentit dhe atë: ka pësuar rrëshqitje të unazave në mes unazës së tretë dhe të katër të qafës, plagë prerëse-shkyese në pjesën murore në anën e djathtë, thyerje e kockës së rrezorit në pjesën që formon nyjën e byzylykut të dorës së djathtë, thyerje të zgjatimit të ulnës në pjesën e poshtme ku formohet nyja e byzylykut të djathtë, tronditje trunore të shkaktuara nga goditja e mjetit të fortë. Ekspertët kanë konstatuar se paditësja për shkak të lëndimeve të pësuar ka përjetuar: dhimbje fizike me intensitet posaçërisht të rëndë disa sekonda deri në humbje të vetëdijes, me intensitet të rëndë 4 ditë, dhimbje që manifestohen për shkak të lëndimeve të shumëfishta trupore, thyerjes së kockës, rrëshqitjes së unazave të qafës të cilat përcillen me dhimbje përkundër terapisë kundër dhimbjeve, me intensitet të mesëm me kohëzgjatje prej 50 ditë, koha e cila ka qenë e nevojshme për konsolidimin e indeve kockore, indeve të buta të ligamenteve dhe pastrimin e plagëve, kurse me intensitet të ulët kanë qenë dhe janë ende prezentë, sidomos gjatë ngarkesës dhe ndryshimit të motit. Frikë, frika primare ka zgjatë disa sekonda, që është përcjell me frikë nga vdekja, frika sekondare me intensitet të lartë ka zgjatur 3 ditë, e manifestuar si gjendje akute me stres dhe është përcjell me ankth dhe konfuzitet, frika sekondare me intensitet mesatar ka zgjatë 4 javë, e manifestuar me vështirësi për tu adaptuar me këtë gjendje, e cila është përcjellë me simptoma të frikës, pagjumësi, si dhe rikrijimi i shpeshtë i ngjarjes traumatike, ndërsa frikë sekondare me intensitet të ulët ka zgjatur edhe për katër muaj tjerë vijues, e manifestuar me simptomat e cekura me lartë por me një intensitet me të ulët. Shëmtim trupor ka në shkallë të ulët, për shkak të vragës në pjesën anësore të kokës në anën e djathtë me madhësi 5 cm dhe gjerësi 1 cm, e dukshme kohë pas kohe, zvogëlim të aktivitetit jetësor ka dhe atë 18.81%, përkujdesja e personit të tretë ka qenë e nevojshme për 50 ditë, e cila ka qenë e nevojshme për mbajtjen e higjenës, veshmbathje dhe ushqimit, ushqimi i përforcuar ka qenë i nevojshëm për 50 ditë, i pasur me proteina, minerale dhe vitamina, rehabilitimi fiziko terapeutik dhe psikik ka qenë i nevojshëm për 40 ditë, për përmasimin e lëvizjeve të qafës dhe nyjës të byzylykut të dorës së djathtë si dhe rritjen e forcës dhe masës muskulore të dobësuara për shkak të pamundësisë së lëvizjeve në kohën e shërimit.

Ka shtuar se për lartësinë e kërkesëpadisë dhe për kategoritë e caktuara të dëmit jomaterial, për pjesën e aprovuar, gjykata ka vendosur në kuptim të nenit 183 të Ligjit mbi Marrëdhëniet

Detyrimeve (LMD-së), duke pasur parasysh rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben kompensimi i gjykuar gjithmonë duke pasur parasysh që kompensim të jetë satisfaksion për të dëmtuarën duke ndikuar kështu në zbutjen e pasojave negative që janë paraqitur si pasojë e dëmit në cenimin e vlerave personale të paditëses. Duke pasur parasysh dhimbjet e pësura fizike, e sidomos intensitetin e dhimbjeve dhe të frikës, kohëzgjatjen e tyre sipas ekspertizës, e duke marrë për bazë edhe rrethanat tjera që ndikojnë në përcaktimin e lartësisë së kompensimit, praktikën gjyqësore, vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit në pjesën e aprovuar.

Gjykata e shkallës së parë është bazuar në mendimin e ekspertëve mjeko-ligjor të cilët kanë bërë ekzaminimin e drejtpërdrejtë të paditëses e po ashtu edhe të shikimit të tërë dokumentacionit mjekësor që i janë bashkangjitur shkresave të lëndës. Gjykata ekspertizën mjekësore të datës 16.02.2021, e ka pranuar në tërësi si të bazuara dhe i ka dhënë besimin e plotë, me rastin e vendosjes për lartësinë e kërkesëpadisë, me arsyetimin se ekspertiza përmban elementet e nevojshme, të dhëna mbi bazën e njohurive profesionale dhe posedon arsye të mjaftueshme të cilat gjykata i vlerësoi si të drejta për vërtetimin e fakteve vendimtare në këtë çështje kontestimore.

Ndërkaq, sa i përket dëmit material të krijuar për përkujdesjen e personit të tretë dhe ushqimit të përforcuar, gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit, duke marrë parasysh faktin se për këto forma të dëmit palët e kanë të pamundur apo shumë të vështirë që të sigurojnë dëshmi konkrete, pasi që kryesisht kujdesin ndaj të dëmtuarve e bëjnë familjarët e tyre dhe ushqimi i përforcuar, i cili përfshinë ushqim shtesë të ushqimit të zakonshëm, është vështirë të argumentohet me prova konkrete. Mirëpo, pasi që paditësja ka pasur nevojë për ndihmën e huaj dhe ushqim të përforcuar (të konstatuar në ekspertizë), të njëjtës ligjërisht i takon ky lloj dëmi i kërkuar në shumat e gjykuara. Ndërsa, sa i përket kërkesës në emër të shpenzimeve të mjekimit, gjykata pas administrimit të provave, ka gjetur se këto shpenzime janë krijuar, pasi që kanë qenë të domosdoshme për paditësen për tu trajtuar në institucionin mjekësor andaj edhe i ka aprovuar të njëjtat në shumën e gjykuar, për të cilat paditësja ka prezantuar prova.

Për pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin jomaterial gjykata e shkallës së parë, ka vlerësuar se kompensimi përtej shumës së gjykuar nuk do të ishte në harmoni me të mirën e shkelur dhe me qëllimin që kompensimi të ishte i drejtë, ndërsa në pjesën e refuzuar të kërkesëpadisë që ndërlidhet me dëmin material gjykata ka vlerësuar se pala paditëse gjykatës nuk i ka ofruar prova me të cilat vërtetohet lartësia e dëmit material të pretenduar, që i referohet kompensimit për rehabilitim klimatik, dhe duke u bazuar në nenin 319 par.1 të LPK-së, gjykata për këtë pjesë të kërkesëpadisë vendosi si në pikën III, të dispozitivit të aktgjykimit.

Për mënyrën e vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë, i është referuar nenit 136, 137, 140, 176 dhe 183 të LMD-së, lidhur me nenin 319 paragraf 1 të LPK-së. Për kamatën gjykata ju ka referuar nenit 382 paragrafi 1 dhe 2 të LMD-së. Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës e ka mbështetur në nenet 449 dhe 452 LPK-së.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, paditësja ka paraqitur ankesë, ndërsa gjykata e shkallës së dytë me aktgjykimin e saj Ac.nr.9487/2021, të datës 23.04.2024, ka vendosur që ta aprovojë pjesërisht ankesën e paditëses, ndërsa aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë pjesërisht, duke vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata Apelit në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera ka theksuar se: nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) të LPK-së, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, por e drejta materiale është aplikuar gabimisht në pjesën që aktgjykimi i ankimuar është ndryshuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë, pasi që aktgjykimi nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale, për të cilat në kuptim të nenit 215 të LPK-së, gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Paditësja, në revizion pretendon se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Megjithatë, këto pretendime janë përmendur vetëm si bazë për atakimin e aktgjykimit të kontestuar, pa specifikuar dhe pa arsyetuar se cila dispozitë konkrete e LPK-së, është shkelur dhe në ç'mënyrë kjo ka ndikuar në rezultatin e procedurës. Për këtë arsye, Gjykata Supreme, kufizon shqyrtimin e saj vetëm në shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare, zotësinë për të qenë palë dhe përfaqësimin e rregullt, për çka edhe ka vlerësuar se i njëjti nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave të procedurës. Dispozitivi i aktgjykimit të shkallës së dytë është i qartë, i kuptueshëm dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin.

Gjykata Supreme pranon qëndrimin juridik të gjykatave të instancave më të ulëta dhe arsyetimit që është dhënë sa i përket detyrimit të paditurës për kompensimin e dëmit të shkaktuar si pasojë e aksidentit të komunikacionit për paditësen, si dhe ndarjen e përgjegjësisë mbi bazën e kontributit të pjesëmarrësve, në shkaktimin e aksidentit, andaj drejtë është konstatuar se baza juridike e kërkesëpadisë, gjen mbështetje në nenin 154, 158 dhe 178 par. 1, të LMD-së, të datës 30.03.1978, i cili ka hyrë në fuqi me datë 01.10.1978.

Me nenin 154 të LMD-së, përcaktohet se: “ Kush i shkakton tjetrit dëmin, ka për detyrë të ja kompensoj, në çoftë se nuk provon se dëmi ka lindur pa fajin e tij ”, me nenin 158 të këtij ligji, përcaktohet se: “ Fajësia ekziston kur dëmtuesi e ka shkaktuar dëmin me dashje apo nga pakujdesia ”, me nenin 178, të këtij ligji, përcaktohet se: “ Në rast aksidenti të shkaktuar nga automjeti në lëvizje që është shkaktuar vetëm për faj të një poseduesi të automjetit vihen në zbatim rregullat mbi përgjegjësinë në bazë të fajësisë ”.

Me nenin 200 të LMD-së, përcaktohet se: “ Për dhimbjet e pësuar fizike, për dhimbjet e pësuar shpirtërore, për shkak të zvogëlimit të aktivitetit të jetës të prishjes, të shkeljes së nderit ose të lirisë, të vdekjes së personit të afërm si dhe për frikën gjykata, po të konstatojë se rrethanat e rastit për frikën dhe zgjatja e tyre justifikon këtë, do të gjykojë kompensim të drejtë në të holla, pavarësisht nga kompensimi dëmit material dhe nga mungesa e dëmit material. Me rastin e vendosjes për kërkesën mbi kompensimin e dëmit jomaterial si dhe mbi shumën e kompensimit të tij, gjykata do të ketë parasysh për rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe të qëllimit të cilit i

shërben ky kompensim e gjithashtu edhe për faktin se mos tu shkojë përshtat synimeve që nuk janë të pajtueshme me natyrën e saj dhe me qëllimin shoqëror”.

Pretendimet e paditëses të theksuara në revizion lidhur me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, nuk janë të themelta. Kjo për shkak se, gjykata e shkallës së dytë, duke vepruar sipas pretendimeve ankimore të paditëses, me të drejtë ka konstatuar se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar LMD, e vitit 2012, andaj konform nenit 215 të LPK-së, në aktgjykimin e saj ka aplikuar dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimit, të datës 30.03.1978, i cili ka hyrë në fuqi më datë 01.10.1978. Duke pas parasysh se dispozitat e ligjit të vjetër nuk kanë dallime substanciale, me ligjin që ka aplikuar gjykata e shkallës së dytë, edhe kjo gjykatë konsideron se aplikimi i dispozitave nga gjykata e shkallës së parë nuk ka ndonjë ndikim në rastin konkret.

Për pjesën e kërkesave për dëmin jomaterial për të cilat është refuzuar revizioni, Gjykata Supreme e Kosovës vlerëson se në kuptim të dispozitave materiale - juridike të cilave u është referuar gjykata e shkallës së parë dhe e shkallës së dytë e në përputhje me gjendjen faktike, drejt është zbatuar e drejta materiale, për arsye se në çdo rast për dëmin jomaterial, gjykata duhet të ketë në konsideratë rëndësinë e shkeljes së të mirës dhe qëllimin të cilit i shërben ky kompensim, duke u kujdesur që kompensimi t'i shkojë përshtati synimeve që synohen me kompensimin e dëmit jomaterial e që është satisfaksion për të dëmtuarit. Mbi këtë bazë duke e pasur parasysh natyrën e lëndimeve që ka pësuar paditësja, llojin dhe kohëzgjatjen e dhembjeve fizike, frikën dhe mënyrën se si është manifestuar frika, shkallën e zvogëlimit të aktivitetit të përgjithshëm jetësor, shkallën e shëmtimit, si dhe rrethanat tjera si moshën e paditëses dhe praktikën e mirë gjyqësore, e të cilat rrethana janë në pajtim të plotë me nenin 200 të LMD-së, rezulton se shumata e gjykuara janë në përputhje me qëllimin e kompensimit. Në këtë rast vlerësohet se gjykata e shkallës së dytë ka vendosur në mënyrë të ekuilibruar në mes të shumave të gjykuara dhe natyrës së lëndimeve përkatësisht dëmeve që ka pësuar paditësja dhe ndarjes së përgjegjësisë dhe kontributit 50% - 50%, në shkaktimin e dëmit, duke siguruar që kompensimi i gjykuar të jetë satisfaksion për të, dhe duke shmangur qëllimet tjera materiale (lukrative) që mund të bien ndesh me qëllimin e satisfaksionit në raste të tilla.

Pretendimet e revizionit lidhur me refuzimin e kompensimit të dëmit material për rehabilitim klimatik, gjykatat e instancës më të ultë drejtë kanë vepruar kur e kanë refuzuar një kërkesë të tillë për faktin se e njëjta nuk është dokumentuar se një dëm i tillë është shkaktuar dhe se ka mbulesë me prova se është paguar shuma e kërkuar.

Pretendimet sa i përket gjykimin të kamatëvonesës dhe datën e fillimit të rrjedhjes së saj. Gjykata Supreme e Kosovës e pranon qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së dytë, e cila në aktgjykimin e kontestuar ka vlerësuar se kamatëvonesa është dashur të aprovohet në shkallën dhe lartësinë e përcaktuar për mjetet e deponuara në bankë mbi një vit pa destinim të caktuar, duke iu referuar nenit 277 të LMD-së (1978), mirëpo ndryshimi i aktgjykimin nuk mund të bëhet duke pasur parasysh ndalesën “reformatio in peius”, të përcaktuar në nenin 203 të LPK-së. Gjykata refuzoj, edhe pretendimin për aplikimin e kamatë vonesës në shkallë prej 12%, sipas nenit 26 paragraf 6 të LSDA-së, për arsyet e theksuara si në aktgjykimin e kontestuar.

Pretendimet në revizion lidhur me përgjegjësinë e paditëses dhe të paditurës janë refuzuar, pasi kjo përgjegjësi është vërtetuar në mënyrë të drejtë nga gjykatat e instancave më të ulëta, nga ka

rezultuar se kemi përgjegjësi të ndarë dhe të ekuilibruar solidare në raport 50% - 50%, bazuar në kontributin dhe lëshimet e konstatuara në ekspertizën e komunikacionit të datës 05.03.2021, si dhe në natyrën, pasojat dhe shkallën e lëndimeve të përcaktuara në ekspertizën mjekësore me shkrim të datës 16.02.2021. Në këtë kontekst, me aktgjykimin e gjykatës së shkallës së dytë janë konsumuar të gjitha pretendimet ankimore të paditëses, përmes vlerësimit objektiv dhe në përputhje me dispozita ligjore, prandaj kjo gjykatë e vlerëson të panevojshme elaborimin e mëtutjeshëm të tyre.

Gjykata Supreme e Kosovës, me rastin e vendosjes sipas këtij aktgjykimi, ka vlerësuar të gjitha pretendimet sipas revizionit të paraqitur, për të cilat ka konstatuar se kryesisht i referohen zbatimi të gabuar të së drejtës materiale që ka të bëjë me lartësinë e shumave të gjykuara palës paditëse në emër të dëmit material dhe jomaterial të gjykuar nga gjykata e shkallës së parë dhe të dytë sipas aktgjykimit të lartcekur, për të cilat kjo gjykatë nuk e ka parë të arsyeshme ti elaboroj secilën veç e veç, ka gjetur se janë të pabazuara dhe pa ndonjë ndikim për vendosje ndryshe, siç ka vendosur kjo gjykatë me anë të këtij aktgjykimi.

Në këtë kuptim nuk janë pranuar pretendimet sipas revizionit nga pala paditëse, për zbatim të gabuar të së drejtës materiale, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, për këtë pjesë të kërkesëpadisë gjykata e shkallës së dytë në përputhje me gjendjen faktike ka aplikuar në mënyrë të drejtë të drejtën materiale, duke i' u referuar nenit 200 të LMD-së.

Nga sa u tha më lartë e në pajtim me nenin 222 të LPK u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË

Rev.nr.582/2024, më datë 23.01.2025.

Kryetari i Kolegjit
Rrustem Thaqi